



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 417/12_prot.

Tiranë, më 04.11.2019

VENDIM
Nr.108, datë 04.11.2019

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 74, DATË 05.06.2019

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 74, datë 05.06.2019, “Mbi përfundimin e verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë, në zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit *****”,

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet informacionit të ardhur nga nëpunësi *****, regjistruar me nr.417 prot., datë 16.04.2019, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është njohur me pretendimet e tij për mungesë të shkaqeve të ligjshme dhe zbatim të gabuar të parimeve të ligjit material, në zhvillimin e një ecurie disiplinore në ngarkim të tij, në përfundim të të cilës Komisioni i Disiplinës me vendimin nr. 15, datë 08.04.2019 (nr. 1488/1 prot., datë 08.04.2019), ka marrë masën disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, për këtë punonjës.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri, ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti duke kërkuar nga institucioni i Autoritetit të Mediave Audiovizive, nëpërmjet shkresës me nr. 417/1 prot., datë 18.04.2019, “Kërkim dokumentacioni për verifikimin paraprak të rastit të nëpunësit *****”, në lidhje me vendimin nr. 15, datë 08.04.2019, të Komisionit Disiplinor, për marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, të gjithë materialin shkresor që pasqyron veprimet administrative të kryera nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga organi disiplinor.

Në përfundim të këtij hetimi administrativ procesi është përbyllur me Vendimin Nr.74, datë 05.06.2019, “Mbi përfundimin e verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë, në zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit *****”, në të cilin është vendosur:

“1. Të kërkoj nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Mediave Audiovizive, të drejtojë procesin administrativ në përmbajtje të të cilit, Komisioni i Disiplinës, në bazë të pikës 1, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të anulojë Vendimin nr. 15, datë 08.04.2019, për dhënien e masës disiplinore, “Largim nga shërbimi civil”, të nëpunësit ***** dhe të rishqyrtojë çështjen duke bërë një rivlerësim të rrethanave të ngjarjes dhe veprimeve të kryera nga nëpunësi në fjalë.

2. Për zgjedhjen e një mase të përshtatshme disiplinore për nëpunësin *****, në përputhje me parimet e përshkallëzimit dhe individualizimit të masës disiplinore parashikuar nga neni 60, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe rrethanat e reja të krijuara pas ndërprerjes së ecurisë.”

Në zbatim të vendimit paralajmëruar nr. 74, datë 05.06.2019, të Komisionerit, institucioni Autoriteti i Mediave Audiovizive, me shkresën nr. 3724 prot., datë 17.10.2019, i ka kthyer përgjigje Komisionerit si më poshtë vijon:

“...

Nga rivlerësimi i rrethanave të ngjarjes dhe veprimeve të kryera nga nëpunësi në fjalë, Komisioni i Disiplinës me Vendimin nr. 16, datë 17.09.2019, vendosi anulimin e vendimit për dhënien e masës disiplinore “Largim nga Shërbimi Civil”, të nëpunësit ***** dhe rikthimin e tij në detyrë në pozicionin “Specialist të Çështjeve Juridike” pranë Drejtorisë Juridike dhe Liçencave, me efekt financiar që prej datës së largimit nga shërbimi civil.

Gjithashtu me Vendimin nr. 17, datë 26.09.2019, Komisioni i Disiplinës i ngritur pranë AMA-së vendosi ndërprerjen e ecurisë disiplinore ndaj *****, duke vlerësuar se nga ana e tij nuk është kryer shkelje me faj.”

Në analizë të praktikës shkresore të këtij rasti, vërej se:

Institucioni Autoritetit të Mediave Audiovizive, me shkresën e tyre nr. 3724 prot., datë 17.10.2019, ka vënë në dispozicion të Komisionerit të gjithë aktet e përpiluara nga Komisioni Disiplinor, pranë këtij institucioni, me qëllim rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë për rastin konkret.

Konstatohet se, nëpunësi ***** me Vendimin nr. 16, datë 17.09.2019, të Komisionit Disiplinor, pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, është rikthyer në detyrë në pozicionin e “Specialistit të Çështjeve Juridike”, pranë Drejtorisë Juridike dhe Liçencave, me efekte financiare që prej datës së largimit nga shërbimi civil, ndërsa me

Vendimin nr. 17, datë 26.09.2019, të këtij Komisioni, është vendosur ndërprerja e ecurisë disiplinore ndaj këtij nëpunësi.

Për sa u parashtrua më sipër, arrij në përfundimin se nga ana e institucionit Autoriteti i Mediave Audiovizive janë zbatuar rekomandimet e lëna në Vendimin Nr. 74, datë 05.06.2019, *“Mbi përfundimin e verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë, në zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit *****”*, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 74, datë 05.06.2019, *“Mbi përfundimin e verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë, në zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit *****”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Autoriteti i Mediave Audiovizive, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 74, datë 05.06.2019.
3. Për këtë vendim të njoftohet Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe nëpunësi *****.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha